

LIGJ
Nr. 49/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 113/2020,
“PËR SHTETËSINË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Pika 3 e nenit 8 shfuqizohet.

Neni 2

Pas nenit 8 shtohet neni 8/a me këtë përmbajtje:

“Neni 8/a
Fitimi i shtetësisë nga martesë

1. I huaji ose e huaja që janë të martuar me shtetase ose shtetas shqiptar, martesë e të cilëve është regjistruar në regjistrin e martesave të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë, fitojnë shtetësinë shqiptare pas kalimit të katër vjetëve nga data e lidhjes së martesës në shtetin e tyre ose në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nëse janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë ose jo.

2. Shtetësia sipas këtij neni jepet edhe kur martesë është lidhur së paku tre vjet përpara datës së aplikimit, me kushtin që i huaji ose e huaja të jenë rezidentë në Republikën e Shqipërisë prej së paku një viti nga data e aplikimit.

3. Shtetësia sipas këtij neni jepet edhe kur martesë është lidhur së paku dy vjet përpara datës së aplikimit, me kushtin që nga lidhja e të huajit ose të huajës me shtetasen ose shtetasin shqiptar të ketë lindur së paku një fëmijë.

4. I huaji ose e huaja që aplikon për fitimin e shtetësisë sipas këtij neni duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara nga shkronjat “dh” dhe “ë” të pikës 1 të nenit 8.”.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Titulli i nenit bëhet “Natyrizimi për interes shtetëror”.

b) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. I huaji fiton shtetësinë shqiptare jashtë kushteve të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji për moshën, njohuritë gjuhësore e historike, si dhe afatin e qëndrimit të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë në rast se shteti shqiptar ka interes të posaçëm shtetëror për krijimin e një lidhjeje të qëndrueshme me personin e huaj për shkak të cilësive, aftësive dhe rrethanave specifike të dobishme të individit ose të veprimtarisë së tij, private ose publike”.

c) Pika 1/1 zhvendoset pas pikës 3 dhe numërohet pika 3/1.

ç) Në vendin e pikës 1/1 vendoset pika e re 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1 Interesi i posaçëm shtetëror identifikohet, mbështetet dhe garantohet përpara Presidentit të Republikës nga ministri që mbulon fushën përkatëse. Nuk pranohen aplikime sipas këtij neni pa dokumentacionin mbështetës-garantues nga këto autoritete.”.

d) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Procedurat e aplikimit dhe e ndërveprimit institucional, kushtet, kriteret, rrethanat, dokumentimi dhe vërtetimi i interesit shtetëror, si dhe rregullat specifike të kontrollit të sigurisë dhe pastërtisë së figurës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton gjithashtu ngritjen e një agjencie shtetërore të posaçme në varësi të ministrit përgjegjës për punët e brendshme, e cila ka kompetencë shqyrtimin, verifikimin dhe vlerësimin e aplikimeve, si dhe të rrethanave që formojnë interes shtetëror për dhënien e shtetësisë sipas këtij neni”.

dh) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Kërkesat e vlerësuara si të ligjshme i përcillen, me propozimin për dhënien e shtetësisë, Presidentit të Republikës nga ministri përgjegjës për punët e brendshme.”.

e) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Natyralizimi i anëtarëve të familjes së personit të natyralizuar sipas këtij neni, në rast se kërkohet, u nënshtrohet kushteve dhe kërkesave të nenit 8 të këtij ligji”.

Neni 4 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.5.2026.

Shpallur me dekretin nr. 333, datë 1.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.